Mësoni për të drejtat tuaja në mjedisin digjital

Udhëzimet e Këshillit të Evropës për të respektuar, mbrojtur dhe plotësuar të drejtat e fëmijëve në mjedisin digjital

Prezantim për fëmijë nën moshën 18 vjeç



www.coe.int/children

Ndërtimi i një Evrope për dhe me fëmijët

COUNCIL OF EUROPE

CONSEIL DE L'EUROPE



Kush e hartoi këtë udhëzues dhe pse?

Këshilli i Evropës është një grup i përbërë prej 46 vendesh evropiane që janë duke punuar së bashku për paqen dhe të drejtat e njeriut.

Ndihmon shtetet evropiane të mbrojnë **të drejtat e fëmijëve – të drejtat tuaja!**

Këtu përfshihen të drejtat tuaja në **mjedisin digjital**

Këshilli i Evropës dëshiron që të rriturit dhe fëmijët të kuptojnë se çfarë duhet bërë për t'u siguruar që fëmijët të gëzojnë të drejtat e tyre në mjedisin digjital.

Të drejtat e fëmijëve janë premtime që qeveritë u kanë bërë fëmijëve për t'i ndihmuar ata të gëzojnë një jetë të mirë.

Mjedisi digjital nënkupton të gjitha mënyrat me të cilat fëmijët përdorin kompjuterët dhe internetin: smartfonet dhe tabletat, lojërat kompjuterike dhe median sociale.

Cilat janë disa nga gjërat më të rëndësishme që duhet të keni parasysh kur mbroni të drejtat e fëmijëve?

Ka 5 gjëra që janë gjithmonë të rëndësishme, dhe që kushdo që vendos për ju apo fëmijë të tjerë, duhet t'i respektojë; dhe këto janë:



1. **Interesi më i lartë i fëmijëve** është një prej gjërave më të rëndësishme për t'u konsideruar kur merren vendime ose ndërmerren veprime.
2. **Fëmijët pësojnë ndryshime që nga momenti kur lindin deri kur arrijnë moshën 18 vjeç.** Adoleshentët dhe fëmijët e vegjël kanë aftësi dhe nevoja të ndryshme.
3. **Fëmijët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.**
4. **Mendimet e fëmijëve duhet të dëgjohen dhe të merren seriozisht.**
5. **Qeveritë** duhet të **inkurajojnë, mbështesin dhe punojnë me të gjithë palët e interesuara** (siç janë bizneset, mësuesit, prindërit dhe fëmijët) për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve.

Interesi më i lartë i fëmijëve nënkupton se kur merret një vendim, së pari duhet të konsiderohet mirëqenia e fëmijës

Qeveritë që duhet të mbështesin fëmijët janë qeveria qendrore, qeveritë lokale, dhe organizatat e lidhura me to

Cilat nga të drejtat tuaja duhet të mbrohen dhe pse?

Të gjithë fëmijët duhet të kenë mundësi të përdorin mjedisin digjital

Ky mjedis duhet:

- Të jetë me një kosto të ulët (dhe nëse është e mundur falas në hapësirat publike).
- Po ashtu, duhet të mundësojë përdorimin nga cilido prej jush me aftësi të kufizuara, që jeton në zonat rurale dhe fëmijët migrantë.







E drejta juaj për informim

- Qeveritë duhet të sigurojnë që ju të keni lehtësi në gjetjen e informacionit të përshtatshëm.
- Ju duhet të mësoni t'i respektoni të tjerët në internet (p.sh. të mos inkurajoni bullizmin ose dhunën).
- Bizneset duhet të sigurojnë informacion mbi kushtet e përdorimit, të cilin ju mund ta gjeni dhe ta kuptoni.

E drejta juaj për të marrë pjesë në vendimmarrje

- Shkollat, qeveritë, bizneset dhe organet ndërkombëtare duhet t'ju pyesin për pikëpamjet tuaja dhe t'i marrin seriozisht.





E drejta juaj për të formuar dhe për t'iu bashkuar grupeve në internet

- Ju nuk duhet të monitoroheni nga autoritetet apo të tjerët gjatë përdorimit të internetit përveç se në rastet kur lejohet me ligj.

E drejta juaj për të luajtur

- Qeveritë dhe bizneset duhet t'ju mbështesin që të luani, të jeni krijues, t'i zgjidhni problemet dhe të punoni së bashku me fëmijët e tjerë.

E drejta juaj e privatësisë dhe mbrojtja e informacionit personal

- Të gjithë duhet të mësojnë për të drejtën tuaj për privatësi.
- Ju duhet të mësoni si ta ruani privatësinë e informacionit tuaj personal në internet.
- Informacioni juaj fëmijëve duhet të përdoret vetëm me lejen tuaj (ose nëse jeni shumë të vegjël, me lejen e prindërve tuaj) dhe nëse është i ligjshëm.
- Ju duhet të jeni në gjendje ta kuptoni si përdoren informacionet tuaja personale dhe si mund t'i fshini apo korrigjoni gabimet.
- Pajisjet inteligjente të instaluara në lodra ose në veshje nuk duhet të përdoren për të mbledhur informacion rreth jush.



E drejta juaj për arsim

- Shkollat duhet të kenë teknologjinë digjitale që ju duhet juve.
- Ju duhet të mësoni aftësitë që ju duhen. Marrja e mbështetjes për këtë është veçanërisht e rëndësishme nëse je vajzë, nëse familja jote është e varfër apo nëse ke aftësi të kufizuar.

E drejta juaj për t'u mbrojtur nga dëmtimi

- Ekzistojnë kontrolle për kufijtë e moshës.
- Ju dhe prindërit tuaj duhet të informoheni për bullizmin, trajtimin e përmbajtjeve të dëmshme dhe rrezikun prej të huajve.
- Ju duhet të jeni në gjendje të denonconi lehtësisht përmbajtje ose sjellje të dëmshme.
- Materialet mbi abuzimin seksual të fëmijëve në internet, janë të ndaluara

Informacioni personal nënkupton emrin, moshën, vendin ku banoni dhe ku ndodheni.

Dëmtimi përfshin: bullizmin; shtyrjen e fëmijëve për të kryer krime; inkurajimin e seksizmit, racizmit, vetëvrasjes ose lëndimit të vetvetes; kumarit; abuzimit seksual; përdorimin e kompjuterëve, tabletave ose telefonave inteligjentë në mënyrë të tepruar që mund të dëmtojnë gjumin ose shëndetin

Çfarë duhet të bëjë qeveria dhe të tjerët për t'u siguruar që ju të gëzoni të drejtat tuaja në mjedisin digjital?

- Të bëjë **ligje dhe politika** që mbrojnë të drejtat tuaja në mjedisin digjital.
- Të sigurojë që të **gjithë të punojnë së bashku.**
- **Të informojë dhe inkurajojë** të gjithë ata që punojnë me fëmijë që të kuptojnë dhe të sigurojnë që ju i gëzoni të drejtat tuaja në mjedisin digjital.
- Të sigurojë që ju të keni akses në mjedisin digjital.
- Të kryejë **studime** për të kuptuar si mundeni ju të përfitoni nga mjedisi digjital dhe të mbroheni nga dëmtimet në mjedisin digjital.
- **Ankesat dhe trajtimi** i tyre. Qeveria duhet të sigurojë që ju dhe prindërit tuaj të keni mundësi të bëni ankesa kur të drejtat tuaja nuk respektohen në mënyra të lehta për t'u kuptuar dhe përdorur.





Trajtimi i ankesave përfshin: ndjesën, heqjen e përmbajtjes së dëmshme, paditë, korrigjimin e informacionit të pasaktë.

© Këshilli i Evropës, Maj 2020.

Paraqitja dhe Ilustrimi : Andy Matthew, The Port Creative, Edinburgh (UK).

Të gjitha kërkesat në lidhje me riprodhimin ose përkthimi i të gjithë ose një pjese të këtij dokumenti duhet t'i drejtohet Drejtorisë së Komunikimi (F-67075 Strasburg Cedex ose botuese@coe.int).

Ky botim përmban versionin miqësor për fëmijë të Rekomandimi CM / Rec (2018) 7 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Udhëzimet për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur standardet për të drejtat e fëmijës në mjedisin digjital.

Ky botim është përkthyer nga Projekti i Këshillit të Evropës T'i Japim Fund Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual të Fëmijëve në Internet@Evropë (EndOCSEA@Europe), me mbështetjen financiare të Fondaciionit 'End Violence Fund'.



Zbuloni udhëzimet dhe mësoni për të drejtat tuaja në mjedisin digjital!

Për të njohur më shumë rreth veprimtarisë së Këshillit të Evropës në fushën e të drejtave të fëmijëve, ju lutem shikoni: **www.coe.int/children**

Ne do të dëshironim të falënderonim Profesoren Laura Lundy dhe Dr Michelle Templeton të Universitetit të Mbretëreshës Belfast (MB), të cilët na ndihmuan të përgatisim këtë version miqësor për fëmijë të udhëzimeve të Këshillit të Evropës, si dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Shqipëri që u përfshinë në përshtatjen e këtij teksti.

QUEEN'S UNIVERSITY BELFAST

CENTRE FOR CHILDREN'S RIGHTS

SQI

Këshilli i Evropës është një organizatë Evropiane e përbërë nga 46 vende anëtare me qendër në Strasburg, Francë. Ky institucion është për t'u siguruar që të gjitha këto vende të mbrojnë të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtat e fëmijëve, duke parandaluar çdo lloj dhune ndaj tyre dhe duke mbështetur fëmijët për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë.

COUNCIL OF EUROPE

CONSEIL DE L'EUROPE